




**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubllanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: +383 38 212 309 e-mail: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**Psh. nr. 745/22**

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organi Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105 dhe nenit 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje prej Vjosa Gradinaj Mexhuani - Kryetare, Agon Ramadani- Referues, Vedat Poterçoi - Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik (OE) "NTP Burimi"- Suharekë me nr protokolli 745/22 kundër njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit: "Furnizim me pelet Ri -tender" me nr. të prokurimit: 651-22-12392-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–Kuvendi Komunal Gjilan, më datën: 05.01.2023, mori këtë:

**V E N D I M**

**1. Aprovohet** si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik "NTP Burimi"- Suharekë, e ushtruar me 07.12.2022, me numër 745/22, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Furnizim me pelet Ri -tender" me nr. të prokurimit: 651-22-12392-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–Kuvendi Komunal Malishevë, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK).

**2. Anulohet**, njoftimi i AK për dhënie të kontratës për aktivitetin e lartcekur të prokurimit, dhe lënda kthehet në **rivlerësim**.

3. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informoj me shkrim OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, të precizuar si në paragrafin paraprak të dispozitivit të këtij vendimi, në të kundërtën OSHP ka të drejtë të ndërmarr masa për mos respektim të vendimit, sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131, të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës.

4. Meqenëse ankesa e OE "NTP Burimi"- Suharekë, aprovohet si e bazuar, i behët kthimi i depozitës së paguar me rastin e parashtrimit të ankesës. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## A r s y e t i m

### *- Faktet dhe rrethanat procedurale –*

Kuvendi Komunal Gjilan nga cilësia e saj si AK, me 29.11. 2022, ka publikuar në Komisionin Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) Njoftimin për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit “Furnizim me pelet Ri -tender” me nr. të prokurimit: 651-22-12392-1-2-1 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK)–Kuvendi Komunal Gjilan, me ç ‘rast elementet qenësore të prokurimit janë precizuar si në vijim: Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 106,750.00€.

Kundër këtij vendimi, me datën 07.12.2022, në OSHP ka parashtruar ankesë OE “NTP Burimi”- Suharekë me nr. 745/22 (Nr. Protokolli).

### *- Vlerësimi dhe administrimi i provave -*

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me datën 18.11.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE ankues të aprovohet si e bazuar;
- Vendimi i atakuar i AK për dhënie të kontratës të anulohet dhe lënda të kthehet në rivlerësim

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër, është pranuar nga të gjitha palët.

Ankuesi “NTP Burimi”, ka parashtruar ankesë kundër Njoftimit për dhënie të kontratës (datë si më sipër) duke pohuar mes tjerash se: (a) gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit AK ka vepruar në kundërshtim Neni 1 të LPP-së, nenin 6 të LPP-së, nenin 7 të LPP-së, nenin 59 i LPP-së, nenin 66 i LPP-së, nenin 69 i LPP-së, si dhe nenin 72 të LPP-së, duke pretenduar se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk plotëson kërkesat e dosjes sa i përket kërkesave për kapacitet teknik/profesional.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherit duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara

si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli konstatoi në vijim se:

Përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër, AK ka zbatuar procedurë të hapur të tenderimit, me kriteret si në vijim: procedurë e hapur; kontratë – furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 106,750.00€.

Pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa OE “NTP Burimi” konsistojnë në faktin se OE i rekomanduar për dhënie të kontratës nuk plotëson kërkesat e dosjes së tenderit, konkretisht pikës 9.1&9.2 kapaciteti teknik dhe profesional, ku është kërkuar që OE të ofroj dëshmi (listën e kontratave të realizuara) për realizimin e furnizimeve të ngjashme për tri vitet e fundit me vlerë minimale 140,000.00€.

OE ankues pretendon se AK nuk ka respektuar nenin 7, 59 dhe 69 të LPP-së, duke pranuar ofertën e papërgjigjshme në kundërshtim me këto nene.

Paneli shqyrtues në mbështetje të mendimit të ekspertit shqyrtues konstatoi se kontratat të cilat janë në realizim e sipër, nuk mund të konsiderohen si kontrata të “realizuara”, andaj kontrata e vetme e realizuar nga lista e OE është kontrata me numër rendor 11 me vlerë 8820€.

Kurse lidhur me listën e kontratave të anëtarit tjetër të OE të rekomanduar, listën e kompanisë Stublla, nga kontratat e përshkruara në këtë listë asnjë kontratë nuk është e natyrës së ngjashme me këtë aktivitet të prokurimit/furnizim, pasi të gjitha ato kontrata janë për ndërtime të objekteve.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde dhe qëllimin parësor të ankesës, Paneli konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, përderisa parashtrësat e palëve dhe veprimet e tyre, përbejnë bazë të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritior. Në këtë rast, Paneli Shqyrtues konstatimet e tij i bazoi kryesisht në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, të cilat mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit, sikurse Ankesat në këtë rast.

#### *- Përfundim –*

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 dhe 69 të LPP. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet jo konform akteve ligjore të AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në këtë rast përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehen sërish në ri-vlerësim sepse, në të kundërtën kjo do të bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP.

Kthimi i një aktiviteti të prokurimit me bazë kontestuese ligjore në ri-vlerësim, është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: “...të siguroj

integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji”.

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, në pajtim me nenin 117 të LPP.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues  
Vjosa Gradinaj Mexhuani



**Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Dhoma e shkallës së parë, departamentit për çështje Administrative në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK- KK Malisheve

1x1 OE ankues

1x1 Arkivës së OSHP-së;